

V E N D I M

NR.95 DATË 14.08. 2008

PËR
DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 72, DATE 24.06.2008 “PER
MIRATIMIN E KONTRATES TIP MES FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICE
DHE FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICE”

Në mbështetje të neneve 9, dhe 13 të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, pikes 4.13, germa A, pika 2, te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike te miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 338 date 19.03.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 14.08.2008, pasi shqyrtoi propozimin e shoqerise KESH Sha per disa ndryshime ne Kontraten Tip midis Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice, lidhur me detyrimet per sherbimin e transmetimit nga ana e blesesit,

Vendosi


Ne Vendimin Nr. 72, date 24.06.2008 te Bordit te Komisionereve te ERE-s “Per miratimin e Kontrates Tip mes Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice”, behen keto ndryshime:

1. Ne piken 3.2, pas fjaleve “... energjise elektrike te siguruar Blesesit.”, shtohen fjalet “...deri ne piken e levrimit, sipas tarifave te miratuara nga ERE.”
2. Ne nenin 4 te shtohet pika 3 me kete permbajtje:

“3. Blerësi do të jetë përgjegjës për sigurimin e të gjithë kapacitetit, shërbimet ndihmëse dhe shërbimeve të transmetimit të kërkuara dhe të ofruara nga OST-ja dhe/ose që lidhen me blerjen e energjisë elektrike nga Blerësi që nga pika e levrimit, një pjesë e të cilave përcaktohen në vijim në këtë marrëveshje, sipas tarifave të miratuara nga ERE.”

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. ___ date 14.08.2008

PËR

**DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 72, DATE 24.06.2008 "PER
MIRATIMIN E KONTRATES TIP MES FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICE
DHE FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICE"**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____